



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 18, Datë 27.01.2012

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|------------|
| - Znj. Anila Jani | Kryetare |
| - Z. Gerdjan Khanari | Nënkryetar |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtare |
| - Z. Zamir Stefani | Anëtar |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 27.01.2012, vazhdoi shqyrtimin e ankesës së ardhur nga një ish-studente e Universitetit Jo Publik “Vitrina” në drejtim të këtij universiteti. Problematika e ngritur nëpërmjet kësaj anekese konsistonte në: Menyren e çregjistrimit nga Universiteti “Vitrina”, si dhe sigurimin e listës së programeve mesimore të vitit të parë akademik të përfunduar nga studentja kundrejt një pagese të caktuar nga universiteti të paparashikuar në kontratën e lidhur ndërmjet këtyre dy paleve.

Komisioni pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur dhe seances degjimore të zhvilluar në këtë mbledhje me përfaqësuesen ligjore të Universitetit Vitrina,

VËREN SE:

Shqyrtimi i ankesës në drejtim të Universitetit Vitrina në lidhje me menyren e çregjistrimit, si dhe sigurimin e listës së programeve mesimore kundrejt pageses nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve ka filluar në mbledhjen e datës 7.11.2011.

Për vlerësimin e plote të kësaj çështjeje, Komisioni ka kërkuar disa here radhazi nga Universiteti Vitrina nëpërmjet shkresave me nr.protokollit 31/1 të datës 14.11.2011 dhe shkresës me nr. protokollit 44/1 të datës 25.01.2012, si dhe nga përfaqësuesja ligjore e këtij universiteti në seancën degjimore të datës 27.01.2012, informacion në lidhje me problematikën e ngritur. Megjithatë, deri me datën 27.01.2012 kur Komisioni ka zhvilluar mbledhjen e tij, nga Universiteti Vitrina nuk është paraqitur asnjë informacion as me shkrim dhe as verbalisht, si dhe për më tepër nga përfaqësuesja e tij ligjore është kërkuar ende kohë për t’u përgatitur në lidhje me çështjen e ngritur. Kerkese, e cila është konsideruar jo serioze

dhe eshte refuzuar nga Komisioni per shkak te afatit kohor (14.11.2011 deri 27.01.2012) qe ka pasur ne dispozicion Universiteti Vitrina per dhenien e informacionit te kerkuar.

Për sa me sipër, Komisioni mbështetur ne nenin 52/1 te Ligjit nr. 9902 “Per Mbrojtjen e Konsumatoreve” i ndryshuar, sipas te cilit “*Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë dhe jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave te këtij ligji*”, konstatoi shkelje te këtij neni, si pasoje e mungesës se dhënies se informacionit te kërkuar nga Komisioni.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur ne nenin 52, pika 4, nenin 52/1 dhe nenin 57 pikën 2/(d) te Ligjit nr. 9902, date 17.04.2008 “*Për mbrojtjen e konsumatoreve*”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6 (c), të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “*Per menyren e funksionimit e te pageses se anetareve te komisionit te mbrojtjes se konsumatoreve, si dhe percaktimin e procedurave te vleresimit te shkeljeve*” .

VENDOSI:

1. Universiteti Vitrina, te gjobitet me shumën 300.000 leke.
2. Universiteti Vitrina, te njoftoje menjëherë Komisionin e Mbrojtjes se Konsumatoreve për pagesën e gjobës brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit te këtij Vendimi.

Kunder Vendimit te Komisionit te Mbrojtjes se Konsumatorit keni te drejte te ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETAR I KOMISIONIT

